

Titulli i lëndës: Morfologji I – Sistem emëror me fjalëformim

Informatat themelore për lëndën	
Njësia akademike:	Fakulteti i Filologjisë
Titulli i lëndës:	Morfologji I - Sistem emëror i shqipes me fjalëformim
Niveli:	Bachelor
Statusi i lëndës:	E obligueshme
Viti i studimeve:	II/3
Numri i orëve në javë:	2+2
Kreditë ECTS:	6
Koha / Vendi:	E mërkurë, 10.30-12.00, 76
Mësimdhënësi:	Prof. Dr. Rrahman Paçarizi
Të dhënat kontaktuese:	+38345765765, email: rrahman.pacarizi@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës:	
Qëllimet e lëndës:	<p>Lënda Fjalëformim me sistem emëror të shqipes, që në fakt është gjysma e parë e morfologjisë, si pjesë e gramatikës, synon t'i fusë studentët në studimet mbi njohjen e formës dhe strukturës së fjalëve të gjuhës shqipe, duke ua mësuar atyre konceptet themelore dhe të avancuara të morfologjisë.</p> <p>Në pjesën e parë flitet për strukturën e fjalëve dhe të fjalëformimit dhe për tipat e fjalëformimit në gjuhën shqipe.</p> <p>Pjesa tjetër e këtij kursi ka për qëllim të pajisë studentët më njohjen të thelluara lidhur me pjesë e ligjëratës që janë pjesë e sistemit nominal të shqipes, që janë emri, mbiemri e përemri, si dhe numërorët. Po ashtu, kursi synon t'i mësojë studentët për ta bërë identifikimin funksional të fjalëve të shqipes dhe klasifikimin po ashtu funksional të tyre nëpër pjesë të ligjëratës</p> <p>Kjo natyrë e morfologjisë së shqipes i bën këto studime edhe më të nevojshme dhe më praktike, duke i përgatitur studentët edhe për kurset e mëpastajme të gramatikës, në pjesën e sintaksës dhe për studime të historisë së gjuhës.</p>
Rezultatet e pritshme të nxënies:	<p>Kursi i Morfologjisë i bën të zotë studentët e gjuhës shqipe që:</p> <ul style="list-style-type: none">• të mësojnë nocionet themelore dhe ato më të avancuara të morfologjisë së shqipes• të nxënë rregullat e fjalëformimit të shqipes• të mësojnë raportet paradigmatiche dhe raportet sintagmatike me rastin e fjalëformimit

	<ul style="list-style-type: none"> të dallojnë format analitike nga format sintetike të bëjnë identifikimin e pjesëve të ligjëratës sipas funksionit të tyre
	Me këtë kurs, studentët përgatiten për t'iu qasur
	pjesës së dytë të gramatikës së shqipes – sintaksës dhe historisë së gjuhës shqipe.

Ngarkesa e studentit (duhet të jetë në përputhje me rezultatet e nxënies së studentit)

Aktiviteti	Orë mësimore	Ditë / Javë	Gjithsej
Ligjëratat	2	15	30
Teori / Punë në laborator / Ushtrime	2	15	30
Punë praktike			
Përgatitje për test intermediar	2	1	2
Konsultime me mësimdhënësin	20 min/javë	15	3
Puna në terren			
Testi, punimi i seminarit	2	2	4
Detyrë shtëpie	3	15	45
Mësimi individual (në bibliotekë apo në shtëpi)	2	15	30
Përgatitja për provimin final	5	1	5
Koha e vlerësimit (testi, kuizi, provimi final)	2	1	2
Projektet, prezantimet, etj.	5	1	5
Totali			156

Metodat e mësimdhënies:	Mësimi organizohet përmes ligjëratave dhe ushtrimeve në klasë. Po ashtu studentët marrin detyra shtëpie dhe fletëteste të vazhdueshme të cilat më pas ushtrohen dhe analizohen gjatë orëve të ushtrimeve. Punimet e seminareve janë një pjesë integrale e zhvillimit të kursit Sistemi Emëror i Shqipes, me ç'rast studentët realizojnë punë të pavarura individuale dhe grupore. Punimet e seminarit shfrytëzohen nga studentët edhe për ta përsosur përdorimin e aparaturës dhe metodologjisë së punës shkencore. Studentët po ashtu kanë dispozicion orët e konsultimeve në zyrë me mësimdhënësin e lëndës
Metodat e vlerësimit:	20% - vlerësimi i parë intermediar 20% - vlerësimi i dytë intermediar 10% - pjesëmarrja në mësim 10% - angazhimi dhe detyrat 40% - provimi final
Literatura primare:	-Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë, Gramatika e Gjuhës Shqipe 1, Tiranë, 2002
Literatura shtesë:	-Rrahman Paçarizi (2020), Fjalëformimi ndajshësor i shqipes, Armagedoni -Rrahman Paçarizi (2015) Konversioni në gjuhën shqipe, Parnas

Hartimi i planit mësimor	
Java	Titulli i ligjëratës
Java 1:	<i>Njohuri të përgjithshme për morfologjinë dhe objektin e studimit</i>
Java 2:	<i>Struktura morfologjike e fjalës</i>
Java 3:	<i>Identifikimi i morfemave, temat e fjalës dhe tipat e fjalëve (struktura dhe fjalëformimi)</i>
Java 4:	<i>Mënyrat dhe tipat e fjalëformimit</i>
Java 5:	<i>Fjalëformimi ndajshtesor në shqipen</i>
Java 6:	<i>Kompozimi, konversioni dhe mënyrat e tjera të fjalëformimit</i>
Java 7:	Vlerësimi i parë intermediar
Java 8:	<i>Emri-njohuritë themelore, grupet leksikore dhe ndarjet</i>
Java 9:	<i>Emri – kategoritë gramatikore</i>
Java 10:	<i>Formimi i emrave</i>
Java 11:	<i>Mbiemri- njohuri të përgjithshme, kategoritë gramatikore</i>
Java 12:	<i>Kategoria e shkallës të mbiemrat dhe emërzimi i mbiemrit</i>
Java 13:	<i>Numërori</i> Vlerësimi i dytë intermediar
Java 14:	<i>Përemri, njohuri të përgjithshme, klasifikimi</i>
Java 15:	<i>Përemrat vetorë, trajtat e shkurtra, vetvetorët dhe dëftorët</i>

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studentët janë të obliguar të respektojnë normat themelore të sjelljes gjatë kohës së ligjëratave dhe ushtrimeve. Gjatë ushtrimeve studentët janë të obliguar të marrin pjesë aktive në mësim interaktiv. Atyre u mundësohet edhe prezantimi individual dhe grupor dhe qasja interaktive në mësim. Po ashtu studentët kanë mundësi që të kryejnë seminarët e obligueshme nga kjo lëndë